



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.9/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit B.N., të cilin me autorizim e përfaqëson avokatja Xh.K., nga Prishtina ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr.462/22. në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.02.05.2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit B.N.; të cilin me autorizim e përfaqëson av.Xh.K., nga Prishtina ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës B.N., të cilin me autorizim e përfaqëson av. Xh.K., nga Prishtina, ka parashtruar ankesë ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil lidhur me lëndën civile C.nr.462/22. Paditësi B.N., ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim ndaj të paditurës E.M.N.-, dhe avokatja Xh.K., ka ankesë se gjyqtari nuk e ka marrë vendimin në afatin ligjor të paraparë me nenin 153 dhe 157 të LPK-së. Respektivisht me dt. 20.12.2022 është mbajtur shqyrtimi kryesor dhe ka përfunduar kjo çështje, por gjer më dt. 22.02.2023 e autorizuara e paditësit avokatja Xh.K., nuk e ka pranuar aktgjykimin. Gjithashtu ka cekur se me dt.06.02.2022 ka shkuar në Gjykatën Themelore në Prizren dhe e ka pyetur gjyqtarin A.B., se pse ende nuk është përpiluar aktgjykimi ku i njëjti i ka thënë "avokati i palës së paditur i cili është caktuar si përfaqësues i përkohshëm do të bëjë ankesë" Kjo për avokaten a qenë e papranueshme dhe absurde se si avokati do të bëjë ankesë kur ende nuk ka aktgjykim të shtypur. Andaj e njëjta ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B., dhe avokatit të palës së paditur N.K., duke cekur se gjyqtari nuk ka vepruar konform nenit 153 dhe 157 të LPK —së dhe nuk e marr vendimin në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shqyrtimit, kurse ndaj avokatit për shkak se i njëjti ka parashtruar ankesë të kundërligjshme dhe me qëllim të përfitimit material.

Autoriteti kompetent Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore ku ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar dhe

provat e bashkangjitura, ka kërkuar deklarate nga gjyqtari i çështjes A.B., si dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.462/22.

Bazuar në të lartcekurat Autoriteti Kompetent konsideron se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur baze për shkelje disiplinore pasi që pretendimet e ankuesit, respektivisht avokates XH.K., nuk qëndrojnë. Me verifikim të shkresave të lëndës është vërtetuar se paditesi B.N., nga Prizreni me të autorizuarën e tij av. XH.K., ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim ndaj të paditurës S.M=N., me (it. 08.02.2022. lënda është evidentuar me C.nr.462/22 si dhe seanca e parë është caktuar me dt. 30.03.2022. E paditura nuk është paraqitur në seancë pasi që gjendet jashtë shtetit dhe në shqyrtimin e dytë me dt. 14.04.2022 e autorizuarja e paditësit ka propozuar që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga ana e Odës së avokatëve duke pasur parasysh se e paditura është jashtë vendit, nuk ka përfaqësues të autorizuar dhe nuk mund të prezantojë në seance. Avokatja ka deponuar shumën e paraparë me ligj për përfaqësuesin e përkohshëm dhe me dt. 26.05.2022 Oda e Avokatëve të Kosovës e ka caktuar avokatin N.K., nga Prizreni si përfaqësues i përkohshëm për të paditurën S.M-N., nga Prizreni. Janë mbajtur edhe tri seanca si dhe në seancën e fundit me dt. 20.12.2022 palët janë deklaruar në fjalën e tyre përmblylëse ku edhe ka përfunduar në tërësi kjo çështje ku gjyqtari pasi që është konsultuar me kolegjin ka marrë Aktgjykim me të cilën është zgjidhur me shkurorëzim martesë në mes të paditësit M.N., si dhe të paditurës S-M.N., Aktgjykimi i bashkangjitur në shkresë të lëndës e dt. 20 dhjetor 2022 është evidentuar në sistemin SMIL me dl. 22.12.2022, pra i njëjti është përpiluar dhe është evidentuar në sistemin SNIIL pas dy dite nga dita e shpalljes.

Me leximin e deklaratës së gjyqtarit A.B., është vërtetuar se i njëjti ka cekur se nga data 20 dhjetor 2022 gjer me 13 shkurt 2023 janë 34 dite pune, kurse 21 dite tjera kanë qenë dite pushimi dhe festa. Gjithashtu ka cekur se nga dt. 29 dhjetor 2022 gjer më 10 janar 2023 ka qenë në pushim vjetor ku pas pushimit gjyqtari së bashku me të gjithë gjyqtarët e divizionit civil janë bartur tek objekti i gjykatës së re dhe ka pasur për obligim të vendoset me të gjitha lëndët dhe të sistemon ato në zyrën e re si dhe në ndërkohe të mbajë edhe 47 seanca të cilat kanë qenë të caktuara në këtë periudhë kohore, andaj edhe ka pasur vonesa në dërgimin e Aktgjykimit kontestues. Të gjitha këto janë verifikuar dhe është vërtetuar se këto të dhuna janë të sakta.

Duke pasur parasysh se lënda si e përfunduar dhe shtypur është evidentuar në SNIIL me dt. 22.12.2022 si dhe duke pasur parasysh të gjitha arsyet e përmendura me lartë Autoriteti kompetent konsideron se gjyqtari me të pranuar lëndën si lende urgjentët e ka caktuar dhe e ka përfunduar me kohë si lëndë me prioritet por se dërgimi është bërë me vonese për shkak të arsyeshme. Është e pamohueshme se gjyqtari duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me padi dhe lëndë me prioritet ka caktuar seancën e parë në afatin ligjor pas pranimit të padisë dhe janë mbajtur 5 seanca ku e fundit është mbajtur me 20.12.2022. Pas fjalës përmblylëse gjyqtari në procesverbal, pas këshillimit dhe votimit me anëtarët e trupit gjykues ka shpallur vendimin për zgjidhje të martesës me shkurorëzim. Gjithashtu edhe caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm është bërë sipas ligjit ku është caktuar avokati N.K., si avokat për palën e paditur. Në baze të verifikimit në sistemin SNIIL është vërtetuar se aktgjykimi është ngarkuar në sistem me dt. 22.12.2022, pra dy ditë pas seancës së fundit të mbajtur. Në muajin dhjetor të vitit 2022 dhe në muajin janar të vitit 2023, gjyqtarët të Divizionit civil janë bartur nga objekti i vjetër i gjykatës në objektin e ri me të gjitha lëndët dhe stafin mbështetës ku të njëjtit kanë pasur angazhim rreth sistemit në këtë objekt. Gjithashtu gjyqtari Atdhe ka qenë në pushim për 10 ditë gjatë muajit janar. Të gjitha këto vërtetojnë ngarkesën dhe angazhimin e gjyqtarit gjatë kësaj periudhe kohore ku i njëjti edhe pse e ka shtypur dhe ngarkuar

lëndën sipas rregullit në sistemin SMIL nuk është dërguar aktgjykimi në afatin ligjor për shkaqe të cilat i kemi cekur më lartë të cilat edhe e arsyetojnë veprimet e gjyqtarit në këtë çështje juridike. Sa i përket veprimeve të avokatit N.K., i cili është caktuar si përfaqësues i përkohshëm për palën e paditur në këtë çështje kjo nuk është në kompetencë të Autoritetit kompetent, respektivisht të gjykatës, por për të njëjtin duhet të deklarohet Oda e avokatëve të Kosovës.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.9/2023, me datë 02.05.2023**



**KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e parapë e drejta e ankesës.**